



Procesverbal nga mbledhja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Nr. 65

Datë: 23. 11. 2017, ora: 11:30

Vendi: Selia e KQZ-së/Prishtinë

Kryesuese e mbledhjes: Valdete Daka, kryetare e KQZ-së

Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ: Betim Gjoshi, Sami Hamiti, Ilir Gashi, Adnan Rustemi, Binak Vishaj, Eshref Vishi, Stevan Veselinoviq, Ercan Spat, Bajram Ljatifi, Ergit Qeli.

SKQZ: Enis Halimi, Krye shef i SKQZ. Miradije Mavriqi, drejtoreshë e ZRPPC. Përkthyes: Vera Dula.

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi (ZLKMP).

RENDI I DITËS

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së nr.64/2017;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të QNR-së;
3. Të ndryshme;

1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;

Valdete Daka: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e 65 të KQZ-së, me pikat e rendit të ditës si në vijim. A ka dikush vërejtje? Plotësime? Urdhëro Betim...

Betim Gjoshi: Gjithsesi besoj se është e rëndësishme që ne me marrë vendim në bazë të vendimit të PZAP-s. Na i ka sjellë vendimet PZAP, i kemi pranuar të gjithë në e-mail dhe,

kështu kemi vepruar gjithmonë. Rreth agjendës që e kemi në QNR që janë të ndërlidhura njëra me tjetrën...

Miradie Mavriqi: Kemi propozimin që ju kemi dërguar para disa ditëve, lidhur me partitë politike.

Adnan Rrustemi: Po, është e vërtetë që ne kemi pranuar përmes e-mailit një vendim të PZAP-it, që natyrisht për bindjen time është skandaloz! Është definitivisht, vendim tërësisht politik: nuk ka asnjë bazë as juridike, as nuk mbështetet në proces zgjedhor. Është për mua një vendim që synon suspendimin e vullnetit të votuesve, suspendimin e zgjedhjeve. Është absurd për nga përmbajtja po ta shohësh, përveç që e dimë të gjithë që për asnjë vendvotim në Prishtinë dhe në Prizren nuk ka pas asnjë kuti pothuajse të votimit në karantinë në QNR. Nuk ka pasur as rekomandim nga QNR-ja për rinumërim apo vendim tjetër të KQZ-së, nuk ka pasur vërejtje dhe as shqetësim në ditën e zgjedhjeve nga asnjë komisionarë! Nuk ka pasur asnjë vërejtje nga komisionarët e partive politike në librin e votimit që do të shërbente si bazë. Madje, ky vendim është absurd kur bëhet fjalë për rinumërimin e votave me kusht: po kërkohet rinumërimin, diçka që nuk është numëruar ende!

Ne e dimë, tha z. Rrustemi se nuk i kemi numëruar as votat me kusht dhe as me postë. S'i ka mundësi me e kushtëzuar KQZ-në për diçka që nuk është numëruar...? Sa i përket rendit të ditës, nuk mundemi ta fusim në rend dite sepse, vendimi është i apelushëm. Janë 24 orë kohë për t'u apeluar në Gjykatën Supreme. Dhe, ne nuk mundemi me marr vendim. Unë vetëm kërkoj nga QNR-ja kur bëhet fjalë për votimin me kusht dhe me postë, që të vazhdoj numërimin e votave me kusht ashtu siç ka qenë i planifikuar, a e kemi të qartë...! S'i ka mundësi me e ditë që ka parregullsi në kuti, s'i ka mundësi PZAP-i me ditë për parregullsi kur ne nuk i kemi numëruar votat, nuk janë hapur kutitë...? Pra, s'i ka mundësi me e ditë rezultatin edhe me u ankua kur nuk i kemi numëruar votat. Kështu që unë kërkoj që mos të jetë në rend dite sepse, s'ka mundësi sepse, jemi në një paligjshmëri tjetër! Dhe le të vazhdon QNR t'a bëjë numërimin e votave me kusht dhe me postë, ashtu siç ka qenë e planifikuar...

Betim Gjoshi: Është mirë të jemi të kujdesshëm. Ne si institucion, e kemi ruajtur seriozitetin dhe nuk kemi pse t'i frikohemi transparencës edhe ligjshmërisë. Ne, me 13 të këtij muaji kemi marr vendim për 440 kuti, po ashtu ka qenë vendim i apelueshëm ditën që e ka marr vendimin PZAP, edhe e kemi bërë rinumërimin. Ne, nuk mund të punojmë me emocione ditë pas dite, as nuk mund ta dirigjojmë asnjë nga ne këtu për agjendën PAZP-n, është mirë me pas një agjendë të përhershme që e kemi pasur...! Nuk kemi nevojë me vonuar as një lloj procesi, nëse një organ tjetër merr vendim ndryshe, sepse ne kemi disa rezultate që më tash janë procesuar në QNR.

Për mu, tha z. Gjoshi, transparenca ofron mundësi, është një standard i arritshëm, ndonëse edhe mund të mos jemi të kënaqur me vendimet e PZAP-it. Ankesat e PZAP-it kanë ardhur si ankesë e tri partive politike, nuk i kemi marr ne vendimin, KQZ-ja...! Edhe si të tilla, kemi detyrim me i zbatuar. Edhe herëve të tjera kur nuk na kanë pëlqyer kemi marr vendime, na duhet të kemi standarde të transparencës dhe me ofruar mundësi. Vendimi kërkon me pas

vëzhgues të mjaftueshëm, media, shoqëria civile etj, që me e pa procesin që do të ndodh në QNR...

Adnan Rrustemi: Në radhë të parë, nuk duhet ta fusim në rend dite edhe nuk mund të marrim vendim në një kohë kur vendimi është i apelueshëm prej gjykatës supreme. Nuk mund të fillojmë aktivitetin në QNR për sa kohë vendimi është duke u shqyrtuar, ose duke u apeluar në gjykatë supreme. Në një vendim tjetër, kjo nënkupton mbas edhe e e legjitimon vendimin e PZAP-it që për mua, është komplet politik dhe i orkestruar. Ne nuk mund të procedojmë asnjë veprim pa përfunduar afati 24 orë për ankesa, në anën tjetër, duhet të jemi korrekt: nuk ka pasur vërejtje as shqetësim në ditën e zgjedhjeve as për Prizren, dhe as për Prishtinë. Nuk ka pasur asnjë raportim në dhomën operative të paktën nga subjektet politike, nuk ka pasur asnjë vërejtje në librat e votimit, në qendra të votimit! Dhe, nuk ka pasur asnjë vendvotim në karantinë, përveç nga një zarfi me kusht të një votuesi...Nuk ka pasur kuti të vendvotimit as në Prishtinë dhe as në Prizren që ka shkuar në auditim dhe në hetim.

Është komplet vendim politik i orkestruar, tha z. Rrustemi. Madje, nuk kanë mundur me e arsyetuar në kuptimin vendimin, ju ka përvjedhur gabime përmbajtësore: kanë vu rinumërim të votave me postë dhe me kusht. Votat me postë, asnjëherë nuk kanë qenë nëpër vendvotime, kanë qenë në KQZ gjatë gjithë kohës kutitë deri 24 orë pas ditës së zgjedhjeve, e të cilat janë edhe sot në QNR. Ato, ende nuk janë hapur asnjëherë, nuk janë numëruar asnjëherë... Ashtu siç nuk janë numëruar votimet me kusht, deri më tani asnjëherë....

Ky, është një vendim absurd: edhe juridikisht, edhe politikisht, është një përpjekje për me e deformuar vullnetin e votuesve....

Ilir Gashi: Unë pajtohem që duhet të hyjë në rend të ditës vendimi i PZAP-s, dhe siç e kemi parë, ato vendime janë marr në bazë të paktën, sa e pash ynë për Prizrenin nga ankesat e Vetëvendosjes dhe e PDK-së. Ne, duhet të marrim vendim mbi bazën e vendimit të PZAP-s. Në qoftë se Gjykata Supreme ndërkohë, sjellë ndonjë vendim tjetër, ne jemi ata që do t'i zbatojmë vendimet e gjykatave tona!

Ne, tha z. Gashi, nuk mund të vazhdojmë me procedimin e votave me kusht, nëse në këto komuna kanë dalë probleme të shfaqura, sipas PZAP-it. Deri sa të zgjedhën, ne duhet me proceduar me rinumërimin, dhe pastaj, duhet të futemi në votimet me kusht. Kështu që, jam pro që kjo të futet në rend dite dhe, ne të shkojmë tutje me zbatimin e tyre...

Sami Hamiti: Edhe unë, në parim jam që të hyjë kjo në rend dite, dhe të votohet. Tash, kërkesa që të pritët afati i ankimimit në gjykatë supreme, unë ndoshta jam më i riu këtu, por, e di që në zgjedhjet lokale dhe nacionale, disa orë më pas kemi shkuar në rinumërim! Tash, a janë politike apo jo vendimet, unë s'e komentoj por, po shihet që 4 ose 5 subjekte politike kanë bërë ankimim atje. Dhe, të gjithëve ju kanë aprovuar ato kërkesa...

Nëse mendojmë që janë selektive, tha z. Hamiti, është çështje tjetër por, unë mendoj që për komunat që janë marr vendim nga PZAP-i me i lanë njëherë, deri sa të kryhet rinumërimi. Tash, mos të bëjmë tensione, kjo është transparenca, tash dikush e merr si çështje politike....!

Prej ditës së parë, ka pasur transparencë, kemi pasur kamera, kemi pasur vëzhguese...Dy komunat, kanë numrin në të madh të votuesve, diferenca është e vogël, shumë më mirë është edhe për subjektin Vetëvendosje...Legjitimohet diçka, janë 85000 mijë vota, janë 200 diferencë dhe me e lanë, hajt se po ecim...!? Është një arsye pse, është kërkuar rinumërimi. Le të legjitimohet...

Eshref Vishi: Ne si KQZ, jemi të thirrur për respektim të ligjit, të procedurave ligjore. Unë nuk mendoj njëjtë sikur propozuesi që të procedohet në rinumërim, megjithëqë atë, duhet të respektohet afati 24 orë nga PZAP-i për ankesa. Sepse, 24 orë është afati i ankesave. Megjithatë, ne nuk duhet të paragjykojmë vendimet e Gjykatës Supreme. Pas përgjigjeve nga gjykata supreme, duhet të procedojmë me dispozitat e vendimit, ashtu siç jepet...

Binak Vishaj: KQZ-ja funksionon që disa vite, kemi praktika për secilën procedurë. Po më çuditin pse po krijojmë praktika të reja prej atyre që kemi pasur...! Shumë shpesh ka ndodhur mos të na pëlqejnë vendimet e panelit zgjedhor, mirëpo jemi të obliguar me ligj ta zbatojmë, cili do që të jetë vendimi tyre. Kështu që, ne nuk mundemi m'i ikë kësaj përgjegjësie, ata e mbajnë përgjegjësin për vendimin që kanë marr, ne jemi të obliguar ta respektojmë. Duhet të filloj rinumërimi për ato vendime që ata kanë marr vendim ti rinumërojmë, kemi edhe në Rahovec rinumërim, ndoshta nuk më pëlqen që është marr vendim që të shkojnë në rinumërim tri vendvotime, mirëpo unë e respektoj...

Duhet të hymë në rinumërim, tha z. Vishaj. Nëse kemi vendim tjetër të gjykatës supreme, normal që edhe atë vendim do ta respektojmë, krejt kjo është procedurë e paraparë dhe, duhet ta respektojmë. Nuk duhet të kemi dilema kush ka drejtë, dhe kush po gabon...

Adnan Rrustemi: E kam një pyetje unë...! Po, nuk mundemi me shti në rend dite. E kam një pyetje për koordinatorin e QNR-së dhe për krye shefin. E para, a ka pasur numërim të votat me kusht dhe me postë që po kërkon PZAP rinumërim, këtu duhet me e qartësuar situatën, po hidhet mjegull... Unë duhet me e arsyetuar mendimin tim, çështja është kështu: ne gjithë e dimë që vendimi është absurd, është politik! Kemi drejtë ankese, por s'i ka mundësi që sot KQZ me vendos ri numërim për sa kohë që ka edhe 24 orë me filluar ne rinumërimin ne kur ka kohë për ankesa? Është njëjtë si mi shpall rezultatet përfundimtare dhe me thënë: k'i kohë për ankesë dhe të certifikohen, e t'i bëje ankesën nesër. Kjo është absurde. Të rinumërohen votat pa u konsumuar afati 24 orë për ankesa dhe pa vendos gjykata supreme.

Unë, tha Rrustemi, po dua me arsyetuar që mos me marrë KQZ-ja vendim. Kërkon rivlerësim të votave të pa vlefshme, fletëvotimet e pa përdorura të votuesit, në asnjë dispozite të ligjit nuk ka formulim të tillë që ka bazë dhe kompetencë PZAP-i me vendos, ndërkohë thotë rinumërim. Kur bëhet rinumërim, bëhet për gjitha votat, kjo është e gjitha manipulim, edhe propagandë. Arsyetimi i vendimit nuk ka bazë ligjore, le të gjen ndokush në Ligjin për Zgjedhje një fjali ku thotë, se PZAP-i ka drejtë ta urdhëroj KQZ-në të bëjë rivlerësimin e votave. Kur bëhet numërimi ose rinumërimi, normalisht që numërohen të gjitha të vlefshme, të pa vlefshme, dhe të pa plotësuar. Unë jam që të mos futet në rend dite diçka që është në trajtim ligjor, nesër përfundon afati për ankesa. Nëse nuk ka ankesa e trajtojmë deri sa të vendos gjykata supreme.

Betim Gjoshi: Ligji i zgjedhjeve i ka disa nene. Edhe procedura në QNR, thuhet që nuk i pengojnë ankesat me vazhduar më tutje. Është mirë m'i lexuar gjitha nenet e ligjit, ne e kemi standard. Para 10 dite kemi marr vendim, dhe të njëjtën ditë që është marrë vendimi i PZAP-it, por nëse merren kështu vendimet, i bie që ne edhe 4 ditë në QNR nuk mundemi me punua. Dhe qytetarët do të presin nga puna jonë. Nëse PZAP-i i ka dhënë disa detyra KQZ-së, nëse Gjykata Supreme i anulon këto vendime të PZAP-it që prapë nuk dua me paragjykuar asgjë, atëherë ne i kemi rezultatet, formularët e rezultateve të numërimit në vendvotim.

Ne, tha Gjoshi: A po duam me humb kohë, apo me vazhduar me proces? E dyta, po fitet për mos numërimin e votave me kusht, por është kërkuar rivlerësim, rinumërim...Por, këto janë detyrat tona që i ka kërkuar PZAP. Janë rivlerësimi, rinumërimi, vetëm nëse duam me e shty këtë proces edhe për 4 dit, mundemi me lënë....! Ne, kemi mundur mos me filluar asnjë procedurë në QNR, me i pritë ankesat, as listat votuese dhe as kutit mos me i procedua por, ne e kemi pasur një dinamikë gjithmonë të punës. Unë, nuk e besoj që ka dikush arsye me ju frikësuar një rinumërimi, rivlerësimi ashtu siç e kanë parashikuar vendimet e PZAP-it. Nuk ka qenë asnjëherë diskutim për ta futur në rend dite vendimin e PZAP-it. Më 13 nëntor të këtij viti, kemi pasur 440 kuti po aq sa i kemi sot, dhe nuk kemi pasur diskutim...Ne, kemi pasur pakënaqësi në shume vendime të PZAP-it, kemi pasur kundërshtim të ankesave, por ne nuk mundemi me e ndryshuar...Ne, nuk e kemi marrë vendimin...

Adnan Rrustemi: E qartë, por ky është vendim i pa precedent. Por, po ashtu, një vendim i KQZ-së që mund të merret sot për me e filluar rinumërimin për sa kohë është afati për ankesa, nuk është në rregull. Do të ketë ankesa. Është presion i drejtpërdrejtë ndaj gjykatës supreme, se vendimi është i papërfillshëm, nuk ka referencë: mbase në të kaluarën, është bërë fjalë për 2-3 vendvotime në nivel komune, apo për kandidat specifik etj. Natyrisht, ka qenë e lehtë me e administrua procesin, por këtë rast këtu bëhet fjalë për vendvotime të tërësishme të komunave....? Ne, duhet të presim vendimin e gjykatës supreme...

Ilir Gashi: Vetëm një vlerësim që e tha kolegu, sigurisht në atë kohë nuk ka qenë anëtar i KQZ-së. Ne, kemi dërguar ne rinumërimin komuna direkt prej KQZ-së, sepse nuk kemi dashur të bëhemi palë...Në 2013, kemi dërguar në rinumërim drejtpërdrejt s'i KQZ se, ka bërë ankesë një subjekt politik, nuk është tragjike kjo punë. Askush, në asnjë mënyrë, nuk e ndërron vullnetin e qytetareve, vetëm konfirmohet ajo për të cilin është votuar, nuk shoh diçka të keqe nga kjo...

Valdete Daka: Kjo ka qenë temë edhe në të kaluarën, por ne kemi marr vendim për rinumërim, pavarësisht se unë konsideroj qe ne as që duhet me marr vendime të tilla. Sepse, vendimet janë urdhëresa nga PZAP-i, ne duhet ta procedojmë urdhëresën e PZAP-it, dhe ato vendime...

Betim Gjoshi: Neni 105.2 i ligjit thotë: Paraqitja e ankesave, nuk e pengon ose ndërpret numërimin.”

Adnan Rrustemi: Ankesat e parashtruara, pikërisht qe 4 ditë janë diskutuar dhe ne e kemi vazhduar numërimin, por ky nen e ndalon abuzimin. E vërtetë është që nuk e ndërpre

numërimin, ne kemi vazhduar, kemi numëruar dhe nuk ka qenë abuzim...! Por, ne duhet me pritë vendimin e gjykatës...

Betim Gjoshi: Janë dy mendime, duhet të ju drejtohem opinionit. Unë, nuk kam asnjë emocion për këto vendime, se transparencës nuk ju kam frikësuar asnjëherë. A dëshirojmë ta shtyjme procesin edhe 4 ditë, apo dëshirojmë të marrim vendim...? Është edhe vendimi i anëtarëve të tjerë, ne po duam me e bllokuar procesin se, edhe mos futja në rënd dite është është indikativë...! Ne, mundemi me vazhduar me komonat ku nuk ka kontest...

Adnan Rrustemi: Nuk jemi në një situatë për të bllokuar, por për të mbrojtur procesin, ose e kundërta, m'i dhanë përkrahje deformimit. Dhe kryetarja, si e pa anshme, e ka të drejtën të paktë me u siguruar që mos me marr vendim të paligjshëm sot...

Binak Vishaj: Kryetare, t'i ki me e respektuar rregulloren e KQZ-së. Duhet me i hedhë në votim dy propozime në KQZ, dhe ne kemi me proceduar tutje. Krejt debati është shtjerrë, ne kemi drejtë vote dhe nuk mund të na menaxhoj askush sepse, na është garantuar me kushtetutë dhe me ligj, kështu që a mundemi me vazhduar më tutje...?

Valdete Daka: Po, atë desha ta bëj, por nuk po më lejohet. I kemi propozimin që vendimi PZAP-it, 4 vendime të PZAP-it të cilat kanë urdhëruar numërimet në komuna respektive. Në disa vendime, për disa vendvotime. Këto 4 vendime, të futen në rend dite sot dhe të vendoset në lidhje me rinumërimin e këtyre kutive të cilat janë urdhëruar nga PZAP-i. Kemi edhe një propozim edhe nga ZRPP –ja që të pezullohen 7 parti të cilat, nuk i kanë mbajtur kuvendet në afatet e parapara me ligj...

Betim Gjoshi: Është edhe agjenda e QNR-së...

Valdete Daka: Që të vazhdohet me numërimin e votave me kusht...! Kush është për këtë rend dite? Kush është kundër...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës me dy vota kundër (Adnan Rrustemi dhe Eshref Vishi)

Eshref Vishi: Unë dua të tregoj pse jam kundër. Jam për, pa vendimin e PZAP-it...

Valdete Daka: Vazhdojmë me pikën e parë. Është miratimi i procesverbalit të mbledhjes së KQZ-së numër 64. A ka dikush vërejtje? Nëse jo, kush është për?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin e mbledhjes së KQZ-së, nr.64/2017

2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të QNR-së

Burim Ahmetaj: Faleminderit kryetare. QNR, në bazë të KQZ-së, ka qenë vendim nr. 22 68/2017 të datës 14.11.2017 për rinumërim të 440 vendvotimeve, pra sipas kërkesës së PZAP-it. Pas procesit të rinumërimit, për shkak të pasaktësisë në tabelë, ka dalë që janë rinumëruar 435 vendvotime. Pra, nga gjithë ky proces i rinumërimit, nuk kemi ndonjë rezultat

që është më ndryshe nga ai i cili është publikuar nga KQZ-ja sa i përket rezultateve të subjekteve politike. Ndërsa, sa i përket rezultateve të kandidatëve, kemi ndryshime. Në raportin pra jush, ka pasur efekt rinumërimi në mandatet e kandidatëve. Duke iu referuar tabelës, ndërrim të kandidatëve ka në komunën e Deçanit 1 ndërrim, në komunën e Istogut kanë qenë 2 ndërrime, në komunën e Lipjanit ka qenë një ndërrim, në komunën e Pejës 1 ndërrim, në komunën e Podujevës 1 ndërrim, në komunën e Prishtinës 2 ndërrime, në komunën e Prizrenit 1 ndërrim, në komunën e Vitisë 1 ndërrim, në komunën e Malishevës 1 ndërrim, dhe në komunën e Graçanicës 1 ndërrim. Pra, janë gjithsej 14 kandidat të cilët janë ndërruar në bazë të rinumërimit që është bërë pas efektit të rinumërimit. Sipas kandidatëve që janë ndërruar, pas procesit të rinumërimit nga AAK janë 5 kandidat, nga PDK janë 3 kandidat, nga LDK janë 2 kandidat, nga Lëvizja Vetëvendosje janë 2 kandidat, nga Nisma për Kosovën 1 kandidat, dhe nga SLS-ja është 1 kandidat. Raporti i QNR-s ka evidentuar të gjithë ata kandidat që kanë fituar mandat sipas ankesave, dhe nga kjo rezulton se 3 kandidatë kanë fituar mandat si pasojë e ankesave në PZAP, ndërsa 10 kandidat të tjerë kanë fituar mandat në bazë të efektit të rinumërimit. Ndërsa, duke ju referuar gjinisë së kandidatëve, janë 7 meshkuj, dhe 7 femra. E keni tabelën para jush të të gjithë kandidatëve që janë ndërruar...

Valdete Daka: Pas rinumërimit që është bërë në bazë të ankesave nga PZAP-i, në komunën e Deçanit, nga partia AAK, kandidatja Lirije Zukaj ka fituar mandatin me gjithsej 161 vota, ndërsa Sofa Rizaj e ka humbur mandatin. Në komunën e Istogut, nga partia LDK kandidatja Edona Mehanolli - Lubeniqi me 203 vota, e ka fituar mandatin, ndërsa kandidatja Krenare Kukleci e ka humbur mandatin. Në komunën e Istogut, nga partia PDK kandidatja Mirushe Sadikaj e ka fituar mandatin, ndërsa Vlora Vuthaj e ka humbur mandatin. Në komunën e Lipjanit, nga partia AAK kandidati Ukë Kryeziu e fiton mandatin, ndërsa Bashkim Budakova e humb mandatin. Në komunën e Pejës, nga partia AAK kandidati Fehim Ademaj e fiton mandatin, ndërsa Lulzim Blakaj e humb mandatin. Në komunën e Podujevës, partia LDK kandidati Qendrim Suftolli e fiton mandatin, ndërsa Bunjamin Hoti, e humb mandatin. Në komunën e Podujevës, nga partia PDK kandidati Fatmir Rudari e fiton mandatin, ndërsa Rafet Fetahu e humb mandatin. Në Prishtinë, nga Lëvizja Vetëvendosje Vala Peshku e fiton mandatin, ndërsa Mimoza Sylejmani e humb mandatin. Në Prishtinë, nga Aleanca për Ardhmerinë e Kosovës, Suzana Kika e fiton mandatin, ndërsa Vasilika Zota - Asllani e humb mandatin. Në Lëvizjen Vetëvendosje në komunën e Prizrenit, kandidatja Mimoza Bushrani e fiton mandatin, ndërsa kandidatja Ana Spaqi, e humb mandatin. Në Skenderaj, nga PDK kandidatja Besarta Meha e fiton mandatin, ndërsa Ferdane Beqiri e humb mandatin. Në Viti, nga AAK kandidati Vehbi Rama e fiton mandatin, ndërsa kandidati Bardhyl Sylejmani e humb mandatin. Në Malishevë, nga Nisma për Kosovën kandidati Demir Bajra e fiton mandatin, ndërsa Genc Shurdhaj e humb mandatin. Dhe në Graçanicë, nga Samostalna Liberalna Stranka kandidati Dushko Aksimoviq e fiton mandatin, ndërsa mandatin e humb Goran Allazi.

Valdete Daka: Materialet të publikohen në ueb faqen tonë...

Betim Gjoshi: Gjatë rinumërimit, veç votave të kandidatëve, janë numëruar edhe votat e

subjektet politike, ndoshta ka qenë mirë edhe me pas ndonjë detaj edhe për mundësinë e ndryshimit të votave të subjekteve politike brenda komunave. Edhe një detaj: po thuhet se kanë fituar s'i rezultat i ankesave të kandidatëve, por i bie që 10 kandidatë kanë përfituar mandatin si rezultat i ankesave të tjera, pra ankesa të ardhura nga PZAP. Krejt kjo, si rezultat i rinumërimit në QNR. Mendoj se të gjitha këto statistika, duhet të publikohet në ueb faqe. Publikimi të bëhet qysh sot...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan raportin e QNR-së

3. Shqyrtimi dhe pezullimi i partive politike

Miradie Mavriqi: Faleminderit...Zyra, ka përgatitur gjatë monitorimit të aktivitetit partive të këtyre rekomandim, dhe konstaton se nga 61 parti politike të regjistruara, 7 nga to si kanë mbajtur kuvendet e tyre zgjedhore sipas statusit të afatit ligjor. Ju e kemi edhe listën e partive politike. Këto subjekte, janë: Partia Politike e Frontit për Bashkim Kombëtar, Partia Konservatore e Kosovës, Boshnjanska Stranka Akcija Kosova, Kosova Turk Adalet Partisi, Hervatska Stranka Kosova, Lëvizja Islame Bashkohu, Centar Demokratske Unije.

Valdete Daka: E kemi raportin...

Bajram Ljatifi: Në rekomandim, nuk është afati se deri kur mund t'i mbajnë këto parti kuvendet, dhe kërkoj nga KQZ që t'i mundësoj Zyrës që t'i vëzhgojë mbajtjet e kuvendeve...

Valdete Daka: Cili është afati kur, këto subjekte kanë kohë që t'i mbajnë kuvendet...?

Miradie Mavriqi: Paskemi një gabim teknik. Afati është 45 ditë nga sot...

Valdete Daka: Kush është për rekomandimin e zyrës...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rekomandimin për pezullimin e 7 subjekteve politike.

Valdete Daka: Vazhdojmë me piken tjetër, e ajo është: Vendosi sipas vendimeve të PZAP-s, si dhe vendosja për agjendën e QNR-së. Pra, kemi propozim që, QNR të vazhdojë numërimin e votave me kusht për ato komuna komuna ku nuk ka ankesa edhe nuk ka mundësi që rezultatet të ndryshohen në bazë të rinumërimit eventual. Të vazhdohet me rinumërimin e votave me kusht për ato komuna...Si dhe e kemi propozimin që të fillohet me rinumërimin e votave sipas vendimit të PZAP –s. Këto janë për komunën e Prizrenit, e gjithë komuna, pra të gjitha vendvotimet shkojnë në rinumërim...Po ashtu, të bëhet rinumërimi në 35 vendvotime në komunën e Dragashit. Si dhe rinumërimi i 3 vendvotimeve në komunën e Rahovecit. Si dhe rinumërimi në komunën e Prishtinës, pra të gjitha vendvotimet e kësaj komune.

Adnan Rrustemi: Qysh po e dini që duhet të shkojë komplet në rinumërim Prishtina dhe Prizreni ? Kjo është një dëshmi që po kontrabandohet. Thojeni kryetare sa vendvotime i ka Prishtina...?

Valdete Daka: Prishtina, i ka..., është komplet me 219 vendvotime...!

Adnan Rrustemi: Nuk shkruan askund se janë të gjitha vendvotimet as të Prizrenit dhe as të Prishtinës, dhe kryetare as nuk e keni marrë mundin të kërkonti prej Sekretariati me na sjellë raportin se, a bëhet fjalë për të gjitha vendvotimet...!? Nuk shkruan askund që është komplet komuna, shkruan mund të jenë...! Edhe njëherë po dua me thanë fjalën time kundër këtij vendimi të PZAP-s, me e denoncua këtë vendim absurd, por edhe me e zbardhë absurditetin. Që nga vendimi i parë, e ku përpiqet me e kamufluar politikisht vendimin, e ku përfshinë në pjesën hyrëse edhe Lëvizjen Vetëvendosje, unë them këtu se në asnjë rast LVV nuk ka bërë ankesë që të rivlerësohen fletëvotimet e pa vlefshme, nuk ka bërë ankesë që të rivlerësohet fletëvotimet e përdorura nga votuesit e që janë shpallë si të paplotësuar ose të zbrazëta...E shihni, janë detajet që e demantojnë vendimin e PZAP-së...E shihni pra: unë jam kundër dhe mendoj se nëse KQZ merr një vendim të këtillë, po futet në paligjshmëri tjetër...

Unë jam kundër, tha z. Rrustemi sepse, thjeshtë po i bëhet presion edhe gjykatës supreme. Ky, është një puq ndaj institucionit, ndaj demokracisë...!

Valdete Daka: Unë nuk jam në bankë të të akuzuarve. Unë, nuk e kamë marrë këtë vendim, ju lutem pse po më drejtohesh mua. Vendimin e merr KQZ-ja, jo Valdete Daka, prandaj se di pse më drejtohesh personalisht...Secili, e bart përgjegjësinë morale dhe penale për çdo vendim. Ju lutem: e patëm propozimin e parë e që, është që të vazhdon agjenda e QNR-ës me numërimin e atyre komunave të cilat nuk kanë ankesa, nuk kanë rinumërim, as nuk do të kenë pengesa për vazhdimin e numërimit të atyre votave me kusht të cilat nuk janë kontestuese, veq komunës së Rahovecit, Dragashit, Prizrenit dhe Prishtinës. Nëse pajtohemi që QNR-ja të mos ndalet, por të filloj rinumërimit e atyre votave me kusht të cilat nuk janë kontestues, dhe nuk janë diskutueshëm. Kush është për që të vazhdohet numërimi...?

Sami Hamiti: Nuk e kamë të qartë qëndrimin e Andanit lidhur me një proces që vërteton diçka? As nuk ka tendencë, është një qëndër numërimi ku, qysh jeni ju të përfaqësuar janë edhe subjektet e tjera. Mos të bëjmë standard të dyfishta. Adnani dhe të gjithë ne e kemi votuar çdo vendim të PZAP-s. Nëse ju kujtohet, në zgjedhjet nacionale kemi vendos brenda ore m'u numëruar votat nga një kërkesë, me sa më kujtohet të një partie nga komuniteti...Ka pas çështje, elemente por, pse po bëhet tash problem...? Nuk e kam të qartë, janë kamerat, vëzhguesit...Është marrë një vendim, t'ë ecim përpara...

Adnan Rrustemi: E para, nuk kemi pasur asnjë precedent kështu. Nuk kemi pas asnjë parregullsi në ditën e zgjedhjeve, në fazën e numërimit, as në dhomën operative. E dyta, përbërja e komisionarëve, ka qenë tërësisht në favor të subjekteve politike të cilat, pak a shumë kanë bërë ankesë për rinumërim. Ne i dimë edhe koalicionet, dhe kanë pas shumëfish më shumë komisionarë. Nuk po i frikësohemi vullnetit të votuesve, por përpjekjeve politike për me e deformua vullnetin e votuesve. Por, nuk ka asnjë bazë ligjore për me marrë vendim për rinumërim të 500 kutive! Nuk ka asnjë referencë në asnjë pikë të vetme në dokumentet që e prezantojnë ditën e zgjedhjeve edhe procesin zgjedhor. Është vendim komplet politik. PZAP, e tregon që është organ politik i manipuluar...

Betim Gjoshi: Ne, është mirë me e ruajt qetësinë. PZAP ka lëshuar komunikatë, dhe mediat e kanë botuar dhe dihet se janë shkuar 2 komuna në rinumërim, Prishtina dhe Prizreni. Dihet sa vendvotime janë...Komisionar ka pas njëjtë, ashtu siç duhet...sipas ligjit sepse, dihen edhe shifrat...Nuk ka këtu manipulime... Adnan, pse nuk e ke respektuar standardin para 10 ditëve...?

Adnan Rrustemi: Nuk ka pas kësi precedenti...?

Betim Gjoshi: Adnan, t'i nuk po lejon me fol, unë e kuptoj gjendjen tënde por, lejo të flasim edhe ne...! E kemi një ritëm pune. QNR le të vazhdoj punën...Pra, ta marrim vendimin për rinumërim të kutive, po numërimi le të fillojë mbasi të bëhet i plotfuqishëm vendimi...

Valdete Daka: Kush është i pakënaqur le të ankohe. Adnan, nuk po ta japë më fjalë...! E patëm një propozim të Betimit. QNR le të vazhdoj me rinumërimin në ato komuna, pra ti nuëmroj votat me kusht...Sa komuna janë: 14...! Pra, ne po marrim vendim për rinumërimin e këtyre komunave...!

Adnan Rrustemi: Unë, po them: nuk ka mundësi me marrë vendim për numërim të pjesshëm, dhe nuk bënë me konstatuar për kutitë me votat me kusht që nuk kanë parregullsi sepse, këtë nuk e din as PZAP, dhe nuk e dimë as ne! Nuk janë hapë zarfat, nuk janë numëruar...Unë, kam kërkesë: me vazhduar numërimi për të gjitha komunat, dhe kërkoj mos me marrë vendim...

Ilir Gashi: Ne, është mirë me e udhëzuar QNR-n mbi bazën e vendimeve që ka marrë PZAP. Cdo vendim tjetër që delë nga një instancë gjyqësore, ne prapë do ta respektojmë. Se di pse ky hezitim...? Të mos presim asnjë minutë...

Valdete Daka: Kush është për rinumërimin e këtyre kutive sipas vendimit të PZAP-së...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan vendimin e PZAP-së. (Kundër: Adnan Rrustemi, dhe Eshref Vishi)

Valdete Daka: QNR, le te vazhdon votat me kusht, së pari...

Për KQZ

Valdete Daka, kryetare
